# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6926
E martë, 20 qershor 2023
Çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## BE-ja pret që Kurti dhe Vuçiqi të shkojnë në Bruksel pa kushte

FAQE 5




AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, KA PARALAJMËRUAR SE NËSE NUK LIROHEN POLICËT E KOSOVËS KËTË JAVË, RIKTHEHET AKULLI NË MARRËDHËNIET ME SERBINË

FAQE 4-5

# RAMA: ALBIN, DIL NGA GUACA E VETIZOLIMIT DHE MOS E HUMB VERIUN DUKE PARË KUDO ARMIQ E TRADHTARË!



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka kërkuar të hënën që Serbia t'i lirojë këtë javë tre policët e Kosovës. Duke publikuar thirrjen e Departamentit Amerikan të Shtetit për lirimin e menjëhershëm të policëve, Rama paralajmëroi Serbinë se kjo "do të jetë java e rikthimit të akullit mes nesh nëse ata nuk lirohen". Në raport me situatën në veri, Rama ka kërkuar nga Kurti që të dalë nga guaca e vetizolimit. "Albin, dil nga guaca e vetizolimit dhe mos e humb veriun duke parë kudo armiq e tradhtarë!", është shprehur Rama

## ZGJEDHJET NË KËSHILLIN E PRINDËRVE, SBASHK-U: MINISTRES NAGAVCI NUK I ËSHTË LARGUAR INATI



## PROJEKTLIGJI PËR PAGËN MINIMALE, ENDE NË DOLLAP TË KUVENDIT TË KOSOVËS




## AKTUALE



**QYTETET PO ZBRAZEN, GJIROKASTRA DHE BERATI ME SHKURTIMIN MË TË MADH TË POPULLSISË** F. 2

**DISKUTOHET PËR SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR KOMUNITETIN SHKALI** F. 7

**SHËNOHET 70-VJETORI I THEMELIMIT TË INSTITUTIT ALBANOLOGJIK** F. 6

## EKONOMI



**KOSOVË - ARABI SAUDITE, THEKSOHET KRIJIMI I LINJAVE TË DREJTPËRDREJTA TË FLUTURIMEVE** F. 6

**BURSAT EVROPIANE E NISIN JAVËN ME RËNIE** F. 8

## SPORT




**KRASNIQI: MË PRET NJË NATË E MADHE, DO TË JAP GJITHÇKA PËR KOSOVËN** F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Qytetet po zbrazen, Gjirokastra dhe Berati me shkurtimin më të madh të popullsisë

**Tiranë, 19 qershor** - Qarqet e Gjirokastrës, të Beratit, të Dibrës dhe të Lezhës patën shkurtimin më të madh të popullsisë gjatë vitit 2022. Ndonëse e gjithë popullsia e Shqipërisë u shkurtuar për 31.8 mijë persona, apo rreth 1.1 për qind, në vitin 2022, Instituti i Statistikave raporton se ishin pikërisht 4 qarqet Gjirokastër, Berat, Dibër dhe Lezhë ato që patën rënie gati tri herë më shumë rënie të popullsisë se mesatarja kombëtare.

Të dhënat e Instat-it, që marrin në konsideratë llogaritjen vjetore të popullsisë, tregojnë se popullsia e Gjirokastrës pati rënien më të fortë vjetore me 3.5 për qind. Ky qark ka treguesit demografikë më të përkeqësuar në vend për shkak të plakjes së popullsisë.

Normat e larta të vdekjeve, largimeve dhe rënia e lindjeve po e çojnë Gjirokastrën drejt shuarjes, edhe pse qarku është një nga destinacionet më të pëlqyera për turizëm.



Berati renditet i dyti me tkurrjen më të fortë vjetore të popullsisë me rreth 3.1 për qind. Popullsia e këtij qarku u shkurtuar mbi 3 600 persona brenda një viti. Pavarësisht se Berati është një nga qarqet më potencialet më të mëdha të turizmit, qyteti 2000-vjeçar po përthith nga viti në vit mijëra turistë nga e gjithë bota, teksa malet përreth, me kanionet e Osumit dhe potencialet për zhvillimin e bujqësisë, janë motive për ta rritur popullsinë e zonës dhe jo për tkurrjen e saj.

Pas Beratit, norma e më e lartë rënies së popullsisë ishte në Dibër me 2,9 %. Edhe pse qarku u lidh me kryeqytetin nëpërmjet rrugës së re që shkurtoi distancën në pak më shumë se një orë, sërish zona po braktiset me shpejtësi.

Pas Dibrës, normën më të lartë të rënies të popullsisë e pati Lezha me 2.6 % brenda një viti. Qarku që ka një turizëm bregdetar, që po zhvillohet fort vitet e fundit, u pakësua me 3 100 banorë vitin e kaluar, teksa bizneset në zonën janë në emergjencë për punonjës.

Gjithashtu, rënie të popullsisë me shumë se mesatarja kombëtare kishin qarqet e Elbasanit (2.5 për qind), Fierit me (2.4 për qind) dhe Korça me (2.5 për qind).

Rënia e popullsie është problemi më serioz që po kalon vendi në dekadën e katërt të tranzicionit. Emigracioni ishte i fortë në tri dekadat e fundit, mirëpo tani kur popullsia në total është zvogëluar ndjeshëm dhe është plakur, pasojat e zbrazjes janë shumë të dukshme.

# Partia gjermane planifikon fushatë për shpërbërjen e BE-së



**Berlin, 19 qershor** - Partia gjermane e të djathtës ekstreme, Alternativa për Gjermaninë (AfD), ka thënë se do ta përfshijë "shpërbërjen" e Bashkimit Evropian, apo për largimin e Gjermanisë nga blloku evropian, në fushatën e ardhshme për zgjedhjet e Parlamentit Evropian.

Zgjedhjet e PE-së pritet të mbahen në qershor të vitit 2024. Në propozim është theksuar se "durimi i liderëve të partisë me BE-në është sosur". "Prandaj, ne kërkojmë shpërbërjen e BE-së dhe duam të krijojmë një komunitet të ri ekonomik evropian, një federatë të kombeve evropiane".

Anëtarët e AfD-së do të votojnë për këtë qëndrim në fund të muajit korrik.

Partia e ka mbështetur idenë e largimit të Gjermanisë nga BE-ja prej të paktën vitit 2019 dhe ka bërë thirrje për shpërbërje të Parlamentit Evropian.

Numri i deputetëve të Parlamentit Evropian ndahet mes vendeve anëtare, duke pasur parasysh numrin e banorëve të tyre, por ka një diskriminim pozitiv në favor të vendeve më të vogla.

Asnjë shtet nuk mund të ketë më pak se gjashtë deputetë, sa kanë Malta, Qiproja dhe Luksemburgu, dhe asnjë vend nuk mund të ketë më shumë se 96 deputetë sa ka Gjermania.

Por, kjo do të thotë se për t'u zgjedhur deputet në Parlamentin Evropian, një kandidati gjerman potencialisht i duhen 10 herë më shumë vota sesa një kolegu të tij në Maltë apo Qipro.

Pas zgjedhjeve evropiane, pason edhe zgjedhja e Komisionit të ri Evropian, presidentit të Këshillit, dhe funksioneve të tjera të larta në institucionet e BE-së.

Parlamenti Evropian është shumë i interesuar të ketë dalje sa më të madhe në këto zgjedhje, pasi deri tash, prej vitit 1979 - kur janë zhvilluar zgjedhjet - e deri në vitin 2014, përqindja e atyre që kanë votuar ka qenë vazhdimisht në rënie.

# Ukraina konfirmon çlirimin e fshatit të parë në rajonin e Zaporizhjës

Kiev, 19 qershor - Zëvendësministrja ukrainase e Mbrojtjes, Hanna Malyar, ka konfirmuar se forcat e armatosura ukrainase kanë rimarrë fshatin e parë në rajonin e Zaporizhjës, pasi Ukraina ka nisur kundërofensivën e saj.

Një ditë më parë guvernatori i instaluar nga Rusia në rajonin ukrainas të Zaporizhjës, Vladimir Rogov, dhe mediet pro-Kremlinit, thanë se forcat ruse janë larguar nga fshati Pjatihatki.

Ndërkaq, Ministria e Mbrojtjes e Rusisë tha se ushtria ruse ka zmbrapsur sulmet ukrainase në këtë fshat.

Malyar tha më 19 qershor se trupat ukrainase kanë çliruar 113 kilometra katrorë për dy javë.

Konfirmimi për marrjen e kontrollit në këtë fshat në Zaporizhja vjen disa orë pasi presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u zotua se shteti i tij do t'i rimarrë të gjitha territoret e humbura teksa Kievi po vazhdon "hapat e çlirimit".

Rusia e ka akuzuar Ukrainën se ka kryer granatime në një qytet në rajonin rus Belgorod.

Sulmet brenda territorit rus janë shpeshtuar së fundi, teksa pushimi i plotë rus i Ukrainës pothuajse ka hyrë në muajin e 16.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Gjykimi i liderëve të UÇK-së, trupi gjykuesi kërkon shkurtimin e kohës për marrjen në pyetje të dëshmitarëve

**Hagë, 19 qershor** - Trupi gjykues në rastin e liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, ka kërkuar shkurtimin e kohës për marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

Në seancën e së hënës, para se të nisë marrja në pyetje e një dëshmitari të nacionalitetit serb, kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Charles Smith III, ka lëshuar tre urdhra gojorë. Urdhri i parë gojor kishte të bënte me shkurtimin e kohës për marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga ana e prokurorisë dhe mbrojtjes.

Gjykatës Smith III tha se trupi gjykues është i shqetësuar me ecurinë kohore të këtij procesi gjyqësor penal, duke u kërkuar palëve në procedurë që pyetjet karshi dëshmitarëve t'i shkurtojnë me arsyetimin se tashmë deklaratat e secilit dëshmitar i ka gjykata. Po ashtu, kryegjykatësi e ka lutur prokurorin që për hir të të akuzuarve, ndaj tyre të zhvillohet procesi gjyqësor në kohë të arsyeshme. Ai ka kërkuar që pyetjet t'i rishikojnë, ndërsa mbrojtjes i ka dhënë afat deri sot (e martë) ta bëjë rishikimin e kohës për marrje në pyetje të dëshmitarëve.

Pas kësaj, seanca ka vazhduar me urdhrin e dytë gojor përmes të cilit për mbrojtjen e Thaçit, Veselit dhe Krasniqi është zgjatur afati për apelimin e dy vendimeve gjyqësore deri më 26 qershor të këtij viti.

Kurse në urdhrin e tretë gojor, me kërkesë të gjykatësit Smith III, seanca ka kaluar në sesion privat. Ndërsa pas shqiptimit të tre urdhrave gojorë seanca ka vazhduar me dëgjimin e dëshmisë së dëshmitarit të dhjetë me numrin (03540).



Në sallën e gjyqit janë paraqitur fizikisht Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, ndërsa Jakup Krasniqi është paraqitur përmes videolidhjes.

Gjatë muajit prill ka filluar gjykimi derisa në seancën e 3 prillit, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe mbrojtësi i viktimave, kanë paraqitur deklarimet hyrëse dhe pas leximit të aktakuzës së ndryshuar nga ana e ZPS-së, ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentari Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, si dhe ish-deputeti Rexhep Selimi të cilët janë deklaruar të pafajshëm për veprat penale që u vihen në barrë.

# Zgjedhjet në Këshillin e Prindërve, SBAShK-u: Ministres Nagavci nuk i është larguar inati

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 19 qershor** - Sindikata Bashkuar e Arsimit, e Shkencës, e Kulturës e Republikës së Kosovës (SBAShK) përmes një komunikate për medie ka hedhur akuza në drejtim të ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci. "Ideja e ministres Nagavci për të shpallur zgjedhje të parakohshme për Këshillin e Prindërve tregon se asaj nuk i ikën dot inati ndaj atyre që nuk ulin kokën e nuk veprojnë e nuk flasin ashtu si do ajo dhe partia në pushtet", thuhet në komunikatën e SBAShK-ut.

Sipas kësaj sindikate, ministrja Nagavci dëshiron ta ketë një Këshill të Prindërve që ua bën aminin fjalëve e vendimeve të saj. "Do që ta ketë një kryetar të këtij Këshilli siç ishte njëri dikur që shante e fyente punëtorët arsimorë dhe sindikatën e tyre pa fije argumenti e pa pikën e turpit e vetëm për t'i hyrë në hatër pushtetit", thuhet në komunikatë.




Sipas SBAShK-ut, ministrja Nagvci do të ishte e lumtur po të prishej uniteti në SBAShK e të bëhej pikë e pesë kjo sindikatë, që duke respektuar zërin e anëtarësisë, që nga çerdhet e deri në universitet, ka bërë të gjitha ato angazhime. "Ministrja Nagavci priti shumë nga veprimet plot mllef të Hekuran Muratit, që shleu tërë anëtarësinë sindikale dhe krijoi një kusht të ri me eKosova. Kot shpresuan Hekurani e Arbëria se punëtorët arsimorë nuk do të regjistrohen rishtazi në këtë platformë dhe do të shuhet SBAShK-u por, për fatin e tyre të keq, kjo nuk ndodhi. SBAShK-u e kaloi edhe këtë sfidë dhe ishte e mbetet sindikata më e organizuar dhe më e fuqishme në Kosovë e më gjerë dhe duke qenë kështu, iu shtua mbështetja nga Sindikata e Mësuesve të Amerikës, por edhe nga Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës dhe nga Internacionalja Botërore e Arsimit", theksohet në komunikatën e SBAShK-ut.

Kjo sindikatë ka bërë me dije se Nagavci ka nëntë muaj që nuk takohet me përfaqësuesit e tyre. "Mirëpo ka kohë që u pa se Nagavci nuk e ka inatin vetëm me SBAShK-un. Asaj nuk i pëlqeu as qëndrimi korrekt i Kryesisë së Këshillit të Prindërve të Kosovës. Nagavci ka dëshiruar që ky Këshill të vjellë vrer ndaj punëtorëve arsimorë gjatë gjithë grevës dje pas saj, por ky Këshill kishte paraqitje të kulturuar. Nuk e ka përkrahur grevën, por nuk fyente punëtorët arsimorë, por kërkonte dialog për të gjetur zgjidhje. Këshilli i Prindërve kritikoi arsyeshëm edhe vendimin e ministres për të mbajtur mësim të shtunave me qëllim të zëvendësimit të orëve të humbura në grevë. Ministrja vendimin e solli e inatosur dhe pa u konsultuar as me Këshillin e Prindërve, as me DKA-të, as me SBAShK-un", është thënë në komunikatën e SBAShK-ut.

## Daut Haradinaj: Rama po mban qëndrim dinjitoz, Kurti po rrëshqet

**Prishtinë, 19 qershor** - Zyrtari i lartë i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka thënë se kryeministrin Edi Rama duhet përgëzuar për qëndrimin dinjitoz që e kishte sot rreth paralajmërimit të rikthimit të raporteve të ngrira me Serbinë në rast të moslirimit të menjëhershëm të policëve të zënë rob. "Albin Kurti, fatkeqësisht, po rrëshqet në humbjen e kontrollit aq sa kishte në veri, po e humb mbështetjen e aleatëve tanë dhe kësisoj po e nxjerr nga fundosja Vuqiçin dhe po e dëmton Kosovën. U bëj thirrje publike përfaqësuesve amerikanë dhe të BE-së që të ndërmarrin hapa konkretë për lirimin e policëve të Republikës së Kosovës dhe mos të lejojnë degradimin e mëtutjeshëm. Amerikë, kemi nevojë për ju! Ne jemi 100 për qind pro", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".





KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, KA PARALAJMËRUAR SE NËSE NUK LIROHEN POLICËT E KOSOVËS KËTË JAVË, RIKTHEHET AKULLI NË MARRËDHËNIET ME SERBINË

# Rama: Albin, dil nga guaca e vetizolimit dhe mos e humb veriun duke parë kudo armiq e tradhtarë!

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka kërkuar të hënën që Serbia t'i lirojë këtë javë tre policët e Kosovës. Duke publikuar thirrjen e Departamentit Amerikan të Shtetit për lirimin e menjëhershëm të policëve, Rama paralajmëroi Serbinë se kjo "do të jetë java e rikthimit të akullit mes nesh nëse ata nuk lirohen". Në raport me situatën në veri, Rama ka kërkuar nga Kurti që të dalë nga guaca e vetizolimit. "Albin, dil nga guaca e vetizolimit dhe mos e humb veriun duke parë kudo armiq e tradhtarë!", është shprehur Rama

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

Prishtinë, 19 qershor - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka kërkuar të hënën lirimin e tre policëve të Kosovës nga ana e Serbisë, të cilët më 14 qershor, derisa ishin duke patrulluar në Leposaviq pranë kufirit me Serbinë, janë rrëmbyer nga forcat serbe.

Duke publikuar thirrjen e Departamentit Amerikan të Shtetit për lirimin e menjëhershëm të policëve, Rama e ka paralajmëruar Serbinë se kjo "do të jetë java e rikthimit të akullit mes nesh nëse ata nuk lirohen".

Rama, gjithashtu, paralajmëroi hapa mbrapa në marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë. "Sa më shumë mbahen në Serbi këta tre burra, që edhe sikur ta kenë shkelur vijën e kufirit, s'kanë kryer asnjë krim, aq më pak do të jetë e mundur që marrëdhëniet tona bilaterale të mos bëjnë shumë hapa mbrapa! Kjo do jetë java e rikthimit të akullit mes nesh nëse ata nuk lirohen!", ka shkruar Rama në "Twitter".

Kryeministri shqiptar tha se "situata mund të agravohet" më shumë nëse kryeministri Albin Kurti "këmbëngul në të tijën kundër aleatëve". "Nga ana tjetër, nëse deeskalimi nuk ndodh, e humbura e madhe do të jetë Kosova sepse Serbia, mbase, nuk jeton dot pa u riizoluar! Druaj shumë se sa më shumë Albini këmbëngul në të tijën kundër aleatëve, aq më shumë situata mund të agravohet, duke e rikthyer KFOR-in në krye të punës! E atëherë lamtumirë për kushedi sa kohë edhe kontrollit formal të shtetit mbi krejt territorin dhe ta gëzojmë një Republikë të KFOR-it në veriun e Kosovës! Albin, dil nga guaca e vetizolimit dhe mos e humb veriun duke parë kudo armiq e tradhtarë! Koha është tani dhe po fluturon!", ka shkruar kryeministri Rama.

Departamenti Amerikan i Shtetit i ka bërë thirrje presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, dhe qeverisë serbe që t'i lirojë "menjëherë dhe pa kushte" tre policët e Kosovës të arrestuar më 14 qershor. "Arrestimi i tyre dhe mbajtja në paraburgim nën akuza të pabaza kanë përkeqësuar situatën tashmë të tensionuar", tha zëdhënësi i DASh-it, Matthew Miller, në një deklaratë për media.

Serbia ka thënë se tre policët e Kosovës janë arrestuar "thellë brenda territorit" të saj, por Kosova e ka quajtur rrëmbim këtë veprim nga forcat serbe dhe ka thënë se ata ishin në territorin e Kosovës. Sipas autoriteteve serbe, policët dyshohet se kanë kryer veprën penale: prodhim, posedim, mbajtje dhe trafikim i paligjshëm i armëve dhe lëndëve plasëse, e cila bart dënimin deri në 12 vjet burg.

Ndërkaq, misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka thënë më 16 qershor se mbetet e paqartë se ku pjesëtarët e Policisë së Kosovës ishin në kohën e arrestimit.

Ky mision tha se ka inspektuar lokacionin ku ka ndodhur ngjarja dhe ka biseduar me përfaqësuesit e institucioneve në Kosovë dhe me autoritetet në Serbi.

Më 16 qershor një gjykatë në Kralevë të Serbisë ka shqiptuar masën e paraburgimit prej 30 ditësh ndaj tre policëve të Kosovës.

Më 18 qershor kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se shteti "po bën gjithçka" që tre policët e Kosovës, të arrestuar nga forcat serbe, "të lirohen sa më shpejt të pacenuar". "I ftojmë edhe një herë faktorët ndërkombëtarë që ta dënojnë agresionin e Serbisë më 14 qershor, kur njësitet e tyre speciale ushtarake dhe policore rrëmbyen policët tanë, njësiti anti-terror dhe ai 'Kobra' i ushtrisë tre policët tanë në Leposaviq të cilët ndodheshin pikërisht te një rrugë e mbyllur ilegale e kontrabandës. Sipas të gjitha gjasave, në bazë të lajmeve që kemi, në fillim të javës që vjen, ambasadori Jetish Jashari, që është shef i Zyrës Ndërlidhëse në Beograd, do të arrijë t'i vizitojë këta tre policë", ka deklaruar Kurti.

Ndërkaq presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha se Beogradi ka kërkuar një ekzaminim poligrafik nga misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) për rastin e tre policëve të arrestuar të Kosovës.

Vuçiqi saktësoi se pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, që kanë

→

# BE-ja pret që Kurti dhe Vuçiqi të shkojnë në Bruksel pa kushte

**Prishtinë, 19 qershor** - Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, që ta pranojnë ftesën për pjesëmarrje në takimin e krizës në Bruksel, duke mos vendosur asnjë kusht.
Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, i ka ftuar Kurtin dhe Vuçiqin për një takim në Bruksel gjatë kësaj jave në mes të tensioneve të rritura mes dy shteteve.
BE-ja ka paralajmëruar se mospërfillja e kësaj ftese mund të ketë pasoja për palët.
Presidenti i Serbisë veçse ka refuzuar të takohet me Kurtin, ndërkaq ky i fundit ende nuk ka vendosur nëse do të marrë pjesë në takimin e Brukselit.
Vuçiqi më 18 qershor deklaroi në Beograd se nuk do të takohet me Kurtin. Megjithatë, ai tha se do të vendosë nëse "teknikisht do të paraqitem në atë takim", duke shtuar se ky do të jetë një vendim i tij strategjik për të cilin do ta informojë opinionin.
Kurti më 19 qershor tha se fillimisht pret që shefi i Zyrës Ndërlidhëse të Kosovës në Beograd t'i takojë policët e Kosovës dhe, pasi ta kuptojë gjendjen e tyre, do të vendosë nëse do ta pranojë ftesën e Borrellit për takim.
Zëdhënësi i BE, Peter Stano, tha se Borrelli i ka ftuar dy liderët për t'u takuar në Bruksel "për të gjetur dalje nga kriza që po e shohim dhe për t'u kthyer në rrugën e dialogut". "Data nuk është caktuar ende sepse palët nuk e kanë konfirmuar pjesëmarrjen. Borrelli pret një sjellje më të përgjegjshme nga dy liderët. BE pret që ata të vijnë pa kushtëzime. Blloku evropian po e përcjell situatën për të parë se a janë palët e gatshme për të gjetur zgjidhje", tha Stano në një konferencë për medie.
Ai shtoi se të hënën gjatë takimit të ministrave të BE-së çështja e tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë do të jetë në agjendë. "Ftesa e Borrellit është ofertë dhe mundësi për ta që të dëshmojnë se pas të gjithave mund të jenë konstruktivë. Nuk është ftesë për ta kënaqur Brukselin, por është për nevojën që të ulen tensionet dhe për të ardhmen evropiane të qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë. E për këtë, askush tjetër përveç Vuçiqi dhe Kurti nuk është përgjegjës", tha Stano.
Që nga fundi i majit tensionet në veri të Kosovës u rritën pasi kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri, me asistimin e Policisë së Kosovës, hynë në ndërtesat komunale, mes kundërshtimeve nga serbët lokalë.
Tensionet kulmuan më 29 maj, kur në Zveçan protestuesit serbë u përleshën me ushtarët e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR. Nga përleshjet u lënduan dhjetëra persona nga të dyja palët.
Më 14 qershor tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë u përkeqësuan edhe më tej, pas arrestimit të tre zyrtarëve policorë të Kosovës. Serbia tha se ata u arrestuan "thellë" brenda territorit të saj, por Kosova tha se ata ishin duke patrulluar në territorin e Kosovës, pranë vijës kufitare me Serbinë në Leposaviq.
Stano u pyet edhe për situatën aktuale dhe fatin e tre policëve të Kosovës që gjenden në paraburgim në Serbi. Ai tha se "për fat nuk ka pasur përshkallëzim të ri fizik në terren, por ende nuk kemi parë as hapa konkretë të menjëhershëm për shtensionim. Prandaj, edhe i kemi ftuar të dy liderët në Bruksel për të punuar në uljen e tensioneve dhe për hapa konkretë". "Deri më tani nuk kemi dëgjuar përgjigje konkrete, përveç deklaratave jokonstruktive publike të tyre", tha Stano. "Në këtë moment po përqendrohemi në thirrjen e Borrellit që liderët të vijnë në Bruksel. Varësisht se si do të shkojë ky takim, do të shohim më pas se si do të veprohet. Veprimet e të dyja palëve do të reflektohen edhe në diskutimin e ministrave, pastaj edhe në rrugëtimin evropian të tyre", përfundoi Stano.
Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania i kanë bërë thirrje Serbisë që t'i lirojë menjëherë tre policët e Kosovës.



bërë arrestimin, janë të gatshëm për një ekzaminim të tillë në mënyrë që të saktësohet vendi se ku u arrestuan policët e Kosovës.
Deputeti shqiptar në Serbi, Shaip Kamberi, ka thënë se ndaj tre policëve të Kosovës të rrëmbyer nga forcat serbe dyshohet se është ushtruar dhunë. "Ndaj tre policëve dyshohet se është ushtruar dhunë, pasi duket që Serbia po kërkon kohë për rikuperim të policëve që të vijnë në gjendje më të mirë. Kjo nga përvoja që kam me forcat speciale serbe në Preshevë kur i arrestonin të rinjtë. Fakti që DASh kërkon lirimin e tyre pa kushte do të thotë se ka të dhënat që i ka KFOR-i, por për arsye politike po mbahet e heshtur e vërteta", ka deklaruar Kamberi në "Euronews Albania".
Raportuesi për Ballkanin Perëndimor në Komisionin e Jashtëm të Bundestagut, Boris Mijatovic, ka deklaruar se Kurti dhe Vuçiqi duhet të ulen në tryezën e bisedimeve për shtensionimin e situatës në veri. Ai në një intervistë për "DW" ka theksuar se nuk ka zgjidhje të lehtë, por duhet shumë punë. "Kryeministri Albin Kurti është zgjedhur me shumicë absolute mbi 50 % të votave. Ai sigurisht është në gjendje të zbatojë atë që ka premtuar tani dhe nuk mund të tregojë kompromise në një koalicion. Kurti është i përkushtuar për punë dhe drejtësi dhe vepron në këtë drejtim. Presidenti serb Aleksandër Vuçiq i ka fituar gjithashtu zgjedhjet, por duhet të përballet me forcat e tij revanshiste dhe nacionaliste në vend dhe të fillojë të përmbushë atë për çka është rënë dakord", u shpreh Mijatovic.
I pyetur rreth "kërcënimeve" nga ana e BE-së dhe ShBA-së për vendosjen e sanksioneve për Kosovën, raportuesi për Ballkanin Perëndimor tha se duhet të jemi të kujdesshëm që të mos veprojmë shumë si lojtarë në këtë situatë. "Ne nuk jemi aktorë politikë në parlamente apo në qeveri. Ne kemi një rol të politikës së jashtme. Ne mund ta mbështetim situatën me shkëmbime diplomatike, por gabojmë kur ndërhyjmë në politikë dhe bëhemi aktorë politikë në terren. Ky është një problem që haset edhe në Bosnjë-Hercegovinë, siç mund ta shohim nga Schmidt. Është më mirë t'i qasemi situatës dhe detyrës me përulësi dhe të përqendrohemi në atë që duam: që Vuçiqi dhe Kurti të ulen në një tryezë dhe të mendojnë se si duhet ta trajtojnë situatën në kufi, në mënyrë që të sigurojnë një të ardhme paqësore të dy vendeve fqinje në Evropë", ka theksuar Mijatovic.

## Kosovë - Arabi Saudite, theksohet krijimi i linjave të drejtpërdrejta të fluturimeve

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka zhvilluar një takim me ministrin e Investimeve të Mbretërisë së Arabisë Saudite, Khalid Al-Falih.
Gjatë takimit palët shprehën vlerësim të lartë për bashkëpunimin e deritanishëm në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite.
Ministri Murati ka theksuar rëndësinë e mbështetjes nga Mbretëria e Arabisë Saudite për përfundimin e rrugës Prishtinë - Mitrovicë, si objektiv i rëndësishëm infrastrukturor që do të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore.
Ministri Murati ka theksuar edhe rëndësinë e krijimit të linjave të drejtpërdrejta të fluturimeve nga Kosova drejt Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe anasjelltas, që do të ndihmonte në zgjerimin e bashkëpunimit në sektorin e turizmit në mes të dy vendeve.
Në fokus të bisedës ishte edhe rëndësia dhe nevoja për investime në sektorin e shëndetësisë në Kosovë, ashtu që të përmirësohet infrastruktura shëndetësore dhe të ngritet kualiteti i shërbimeve shëndetësore për qytetarët.
Nga ana e tij, ministri Al-Falih konfirmoi vullnetin e Mbretërisë së Arabisë Saudite për ta mbështetur Kosovën me investime në sektorët e lartpërmendur, si dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm për zhvillimin e vendit.



Ai shprehu përkushtimin e thellë për ta forcuar partneritetin ndërmjet dy vendeve.

# Shënohet 70-vjetori i themelimit të Institutit Albanologjik

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ishte i ftuar në mesin e folësve në akademinë solemne për 70-vjetorin e themelimit të Institutit Albanologjik.
Të pranishëm ishin edhe drejtori i Institutit Albanologjik, Hysen Matoshi, akademik profesor Rexhep Qosja, profesorët Lulzim Lajçi e Kudusi Lama, shefja e Zyrës Ndërlidhëse Greke në Kosovë, Heleni Vakali dhe studiues.
Me një fjalë rasti para të pranishmëve kryeministri Kurti tha se jeta dhe veprimtaria e Institutit ishte e lidhur ngushtë me fatin e popullit që e përfaqësonte, me fatin e popullit shqiptar. Kurti, duke kujtuar themeluesit e Institutit Albanologjik, vendimi i të cilit u shpall më 29 korrik 1953, tha se të merresh me të kaluarën, do thotë të hedhësh dritë në të tashmen dhe në të ardhmen.
Sipas tij, Instituti Albanologjik u bë institucioni i parë kërkimor-shkencor që do të merrej vetëm me studimin e kulturës shpirtërore dhe materiale të shqiptarëve pas Luftë së Dytë Botërore.




Kurti ka theksuar se nga ky vështrim Instituti Albanologjik paraqet Institutin e dritës, sidomos për shqiptarët e Kosovës dhe për ata të trojeve të tjera nën ish-Jugosllavi. "Veprimtaria jetëshkurtër e Institutit, në fazën e parë, hapja në vitin 1953 dhe mbyllja në dhjetor të 1955-s, ishte tregues i qartë i ballafaqimeve të pandalshme të shqiptarëve me politikën shoviniste serbomadhe të kohës, në krye të së cilës ishte ministri i atëhershëm, i Brendshëm, Aleksandër Rankoviq, që përpiqej me çdo kusht ta bënte sa më të rëndë jetën e shqiptarëve. Kjo politikë që synonte ta kthente në ferr jetën e tyre, e bënte këtë në mënyrë që të detyronte sa më shumë shqiptarë të shpërnguleshin nga trojet e tyre", ka deklaruar ai.
Më tutje, Kurti ka theksuar se data kur është hapur Instituti për herë të parë, më 29 korrik 1953, është saktësisht në 40-vjetorin e Konferencës së Londrës. "Pra, thua se është treguar që, pavarësisht padrejtësisë së copëtimit të shqiptarëve, ka diçka që është e pandalshme dhe që jo vetëm vazhdon, por edhe bëhet institucion", u shpreh Kurti, duke theksuar se Instituti Albanologjik e ka pësuar politikën e kohës, por Instituti Albanologjik e ka kombëtarizuar edhe politikën edhe kohën, sidomos sot, kur ballafaqimi me gjuhë e me vlera të huaja kulturore është aq i madh e aq sfidues dhe kur kemi një rikthim të revizionizmit në histori dhe të gjeopolitikës në glob, Instituti Albanologjik padyshim që do të vazhdojë të jetë në qendër të zhvillimeve shoqërore, kulturore, linguistike e, pse jo, edhe politike të shtetit tonë e të kombit tonë.

## Nis ndërtimi i një çerdheje dhe një shkolle në Podujevë

PODUJEVË, 19 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të hënën ishte i pranishëm në qytetin e Podujevës për vënien e gurthemelit të shkollës fillore në fshatin Dumosh, si dhe në vënien e gurthemelit të çerdhes në qytetin e Podujevës.
Në Dumosh të Podujevës, kryeministri Kurti me kryetarin Shpejtim Bulliqi, drejtorin e shkollës dhe nënën e dëshmorit Ali Ajeti, Vahiden, bashkëvendosën gurthemelin e shkollës në vlerë prej 560 mijë eurosh, financim ky i mundësuar nga buxheti komunal. Kjo shkollë ka kapacitetin për 170 nxënës dhe do të përfshijë tet dhoma mësimi.
Po ashtu, qyteti i Podujevës do të bëhet edhe me një çerdhe të re me investim afër 700 mijë euro, gurthemelin e së cilës e vendosi kryeministri Kurti. Me këtë rast, ai njoftoi se objekti i çerdhes me sipërfaqe 1 400 metra katrorë është i destinuar për 150 fëmijë.
Në këtë ambient fëmijët do të zotërojnë 7 dhoma për qëndrim, 3 dhoma të gjumit për fëmijë, hapësirën për shumë qëllime, kuzhinën, trapezarinë, dhomën e mjekut, dhomën e psikologut, administratën, si dhe hapësira teknike. Për këtë çerdhe, sipas kryeministrit, do të punësohen 15 edukatore dhe pesë persona staf administrativ.
Kryeministri Kurti tregoi se çerdhe si kjo janë ndërtuar edhe katër të reja në vitin 2021/2022, përderisa në implementim janë edhe 14 çerdhe të reja në Kosovë e 5 adaptime, ndërkaq në planifikim edhe 17 çerdhe të tjera e 5 adaptime të shkollave në kopshte.
"Brenda dy vjetëve e kemi shtuar buxhetin e shtetit për arsim për 26 për qind, kemi rritur shumë numrin e bursave edhe për nxënës të komuniteteve, edhe për studentë, në veçanti për vajza, për ato që studiojnë në degët STEM, pra shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë. Kemi pasur mbi 1 300 bursa për vitin shkollor 2021/2022 e në këtë vit i kemi shtuar edhe 2 000 bursa të tjera me dy milionë euro", ka thënë Kurti.



## Pesë ditë nga rrëmbimi i policëve, Krasniqi: Vuçiqi po refuzon lirimin e tyre, ndërsa Kurti po na mban në errësirë në lidhje me situatën



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë të hënën se janë bërë pesë ditë nga rrëmbimi i tre policëve të Kosovës nga forcat serbe. Sipas tij, për pesë ditë nuk kemi asnjë informacion për gjendjen e tyre shëndetësore, trajtimin e tyre nga autoritetet serbe dhe, fatkeqësisht, ende asnjë vizitë te ta. "Derisa Serbia dhe Vuçiqi po refuzojnë të lirojnë policët tanë dhe kundërligjshëm po i mbajnë në paraburgim, në anën tjetër, kryeministri dhe Qeveria po na mbajnë në errësirë në lidhje me situatën e tyre. Kërkoj nga qeveria që të luaj një rol shumë më aktiv dhe të përgjegjshëm për rikthimin sa më parë në shtëpi të Rifat Zekës, Beqir Sefës e Shemsi Mustafës. Mbi të gjitha, kërkoj nga kryeministri që të tejkaloj inatet e tij personale dhe të shtoj bashkëpunimin e koordinimin me partnerët tanë ndërkombëtarë - si mënyra më e shpejtë dhe efikase për lirimin e tyre", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

# Diskutohet për sfidat dhe mundësitë për komunitetin shkali



Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të hënën ishte pjesë e tryezës së organizuar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve e Zyrës së Kryeministrit, në të cilën u diskutua për sfidat dhe mundësitë për komunitetin Ashkali. Në fjalën e tij, kryeministri Kurti fillimisht theksoi se për të përparuar si shoqëri është i domosdoshëm, që përparimi i vazhdueshëm të jetë i të gjithë qytetarëve pa dallim. Ai tha se edhe qeveria është e përkushtuar dhe punon që të gjithë qytetarët e Kosovës të trajtohen pa diskriminim.

Kurti përmendi të arriturat me rëndësi në këtë drejtim, si miratimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Ashkali dhe Rom 2022-2026, Platformën Kombëtare për Raportimin e Rasteve të Diskriminimit ndaj Komuniteteve Ashkali, Rom dhe Egjiptian.

Ndërsa, siç tha kryeministri, në dy vitet e fundit përmes masave të zbatuara dhe granteve të ndara janë mbështetur të gjitha kategoritë sociale dhe komunitetet. Ai shtoi se janë ndarë edhe bursa për studentë të komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptian, por edhe qendrat mësimore të fëmijëve të këtyre komuniteteve, që 104 ashkali, rom dhe egjiptian kanë përfituar nga trajnimet në Qendrën e Trajnimit Profesional, e nëpërmjet platformës Superpuna, qeveria po i subvencionon të rinjtë për vende të reja të punës për ta.

Krahas kësaj, Zyra për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit ka mbështetur organizatat dhe mediet e komuniteteve. Sipas Kurtit, janë ndarë gjithsej 96 grante për organizata për projekte nga të cilat përfitojnë komunitetet joshumicë, ndërkaq që vazhdon të jetë thirrja e hapur për grante me vlerë të përgjithshme 300 mijë euro për organizata joqeveritare dhe 100 mijë euro për media.

U tha se në të njëjtën kohë Ministria për Komunitete dhe Kthim ka mbështetur 123 projekte për biznese të vogla dhe startup-e për komunitetet joshumicë. "Prej tyre, 10 për komunitetin ashkali. Kjo ministri ka ndarë edhe fonde për 19 shtëpi që do të ndërtohen për familje me nevojë, përfshirë edhe ato nga komuniteti ashkali. Janë ndarë edhe 373 pako ushqimore dhe higjienike, prej të cilave 94 për komunitetin ashkali, apo përafërsisht 1/4. Po angazhohemi bashkë, institucionet, organizatat dhe qytetarët, për t'i shtyrë përpara përpjekjet për një të ardhme gjithëpërfshirëse e cila nuk e lë askënd mbrapa, me të drejta dhe mundësi të barabarta, të gjithë e pa dallim", tha kryeministri, duke potencuar se na duhen edhe më shumë rezultate, sepse fundja të arriturat kanë për qëllim që në të ardhmen të jenë edhe më të mëdha. Çdo sukses që e kemi është në funksion të një suksesi më të madh që na pret në të ardhmen.

Ndërkaq, deputeti nga radhët e komuniteteve në Kuvendin e Kosovës, Bekim Arifi, pasi falënderoi për organizimin e kësaj tryeze, tha se kryeministri Kurti me praninë e tij në çdo ngjarje e organizim, po dëshmon që komuniteti ashkali është i rëndësishëm për Kosovën.

## Në QKUK për pesë muaj u kryen mbi 3 200 lindje



PRISHTINË, 19 QERSHOR - 3 216 lindje janë kryer nga 1 janari deri në fund të muajit maj të vitit 2023 në kuadër të Klinikës Gjinekologjike-Obstetrike. Prej tyre, 1 200 janë kryer me operacion, kurse të tjerat përmes procesit normal të lindjes. Nga numri i përgjithshëm i lindjeve, 1 629 janë femra dhe 1 688 të gjinisë mashkullore. Ka pasur 97 raste të binjakëve dhe dy raste të trinjakëve.

## Dogana sekuestron cigare elektronike dhe pa banderola në Gjakovë

**Prishtinë, 19 qershor** - Dogana e Kosovës ka njoftuar se pas pranimit të informatave se në qytetin e Gjakovës, respektivisht në një njësi biznesi tregtohet cigare pa banderola, njësitë relevante kanë organizuar një kontroll. Sipas njoftimit, me këtë rast është gjetur një sasi e konsiderueshme e cigareve, cigareve elektronike dhe produkteve të tjera të duhanit për të cilat personi përgjegjës nuk posedonte dokumente dhe, si të tilla, janë kontrabanduar në Kosovë. Po ashtu, zyrtarët doganorë kanë organizuar një plan operativ me qëllim të parandalimit të kontrabandimit të mallrave dhe me këtë rast është zbuluar dhe parandaluar një rast tentim-kontrabandimi i një makine hidraulike për prerjen e drunjve. "Rasti i tretë është zbuluar në magjistralen Ferizaj-Kaçanik në kuadër të planit të përbashkët operativ të Doganës, ATK-së dhe Policisë së Kosovës, ku është arritur të identifikohet një veturë e cila ishte duke transportuar mall me origjinë të huaj e për të cilën pala nuk posedonte dokumentacion që dëshmon se ky mall ka hyrë përmes rrugëve ilegale në Kosovë (mall i kontrabanduar)", ka njoftuar Dogana.

Të gjitha mallrat janë konfiskuar si dhe ka filluar procedura kundërvajtës ndaj personave përgjegjës.



# Projektligji për Pagën Minimale, ende në dollap të Kuvendit të Kosovës




**Prishtinë, 19 qershor** - Ndonëse Projektligji për Pagën Minimale ka kaluar në Komisionin për Buxhet, ai ende nuk u është dërguar deputetëve për votim në lexim të dytë. Kjo ende nuk dihet se kur do të ndodhë derisa anëtarët e Komisionit për Buxhet tregojnë se kur të rritet paga minimale, do të ketë rritje edhe për kategoritë e dala nga lufta.

Edhe pak ditë bëhet një vit prej se në Kuvend u miratua në lexim të parë Projektligji për Pagën Minimale. Por, prej atëherë, përkundër disa tentimeve që i njëjti të kalojë edhe në lexim të dytë e të bëhet i plotfuqishëm, një gjë e tillë nuk u arrit. Megjithëse ka kaluar kohë, ende nuk dihet se kur do të sillet edhe njëherë ky projektligj që nxiti protestat e organizatave të dala nga lufta.

Zyrtarët e Kuvendit të Kosovës nuk kanë kthyer përgjigje për këtë temë, por deputeti Pal Lekaj nga AAK-ja thotë se në komisionin për buxhet janë miratuar ndryshimet e kërkuar. "Po ky ligj është miratuar në Komisionin për Buxhet. Është e ligjshme të procedohet për në Kuvend e pastaj deputetët do ta japin votën për ose kundër. Çdo shmangie nga ligjet dhe Rregullorja e Kuvendit është atak mbi demokracinë, mbi autonominë e deputetit", ka thënë Pal Lekaj.

Edhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) thonë se ky projektligj duhet të sillet sa më shpejt në Kuvend e të mos shmanget në këtë formë. "Përderisa kanë proklamuar e deklaruar se do ta rritin pagën minimale, nuk e kanë bërë në nivelin që kanë kërkuar vetë sektori, dhe tanimë për disa muaj është bllokuar nga vetë deputetët e pushtetit", ka sqaruar deputeti Besian Mustafa.

Nga organizatat e dala nga lufta thonë se gjatë kësaj kohe nuk kanë pasur fare komunikim me asnjë institucion për kërkesat e tyre, por nëse ndodh e njëjta si në të kaluarën, sërish do të protestojnë. "Nuk guxon të pësojë ndryshime dhe nuk duhet të hiqen veteranët nga definicioni se si është e obliguar qeveria, ta respektojë ligjin, në të kundërtën do t'i kemi reagimet tona. Do të protestojmë. I kemi bërë thirrje çdo deputeti të çdo partie që të mos bëjë një gabim të tillë", ka shtuar Xhavit Jashari, kryetar i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve të UÇK-së.

Ekzekutivi gjatë vitit të kaluar e këtë vit disa herë ka përmendur rritjen e pagës minimale në vend, e cila nuk ka pasur ndryshime që nga viti 2011. Ky projektligj, i cili është miratuar në lexim të parë në qershor të vitit të kaluar, parasheh rritjen e pagës minimale në 264 euro bruto, apo 250 euro neto, nga 130-170 sa është aktualisht. /Dukagjini

## Bursat evropiane e nisin javën me rënie

**Prishtinë, 19 qershor** - Bursat evropiane po qëndrojnë në rënie në sesionin e parë të kësaj jave, pasi investitorët janë të shqetësuar për ngadalësimin e ekonomisë globale, sidomos asaj kineze. Indeksi evropian stok 600 e ka nisur ditën në rënie me 0.5 për qind, ndërsa sektori farmaceutik kryeson humbjet në rënie me 1.7 për qind.

Edhe sektori i naftës dhe gazit është në rënie me rreth 0.8 për qind.

Ndërkohë, shumica e tregjeve në rajonin e Azi-Paqësorit kanë publikuar humbje, por Nikkei i Tokios po qëndron në nivelin më të lartë në 33 vitet e fundit.

Në fokus të tregjeve do të jenë edhe takimet diplomatike në mes të ShBA-së dhe Kinës.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, po zhvillon një vizitë zyrtare në Pekin, në përpjekje për t'i përmirësuar marrëdhëniet mes dy vendeve.

Megjithatë, volumi i shkëmbimeve tregtare pritet të jetë i ulët gjatë ditës së sotme, pasi Wall Street do të ketë pushim me rastin e një feste kombëtare.



# Tërmetet, shpërthimet, cunamit: Militarizimi i natyrës si mjet në luftërat e ardhshme



Nga Emmanuel PIETROBON

Që nga vitet 1940, shkencëtarët ushtarakë të fuqive të mëdha, kanë studiuar fenomenet e mëdha shkatërruese të natyrës, nga tërmetet deri tek stuhitë, me objektivin e dyfishtë të kuptimit të sekreteve të tyre dhe nëse është e mundur aktivizimin artificial dhe kontrollimin e tyre.

Njerëzit e zakonshëm janë kryesisht të pavetëdijshëm për eksperimentet mbi militarizimin e natyrës, disa prej të cilave janë kryer në natyrë, në kontekste lufte. Por armët mjedisore të shkatërrimit në masë janë një realitet. Sepse luftërat e së ardhmes, do të zhvillohen ndoshta edhe me tajfunë dhe stuhi të krijuara artificialisht.

## Në kërkim të cunamit artificial

1944, Universiteti i Okland, Zelanda e Re. Është kultimi i Betejës së Paqësorit midis kamikazëve të Perandorisë Japoneze dhe Forcave Ajrore britanike dhe amerikane. Dëshira për t'i dhënë fund konfliktit është e madhe, edhe sepse po rritet numri i të vdekurve në radhët e aleatëve.

Shkencëtari nga Zelanda e Re, Tomas Liç beson se ka gjetur zgjidhjen: një cunami artificial. Ideja e e tij për shkaktimin e një cunami apokaliptik nëpërmjet bombave të hedhura në det, arrin fillimisht në Londër dhe më pas në Uashington. Në SHBA po punohej prej disa kohësh për ndërtimin e bombës atomike, ndaj kishte një interes të veçantë për idetë e neo-zelandezit.

Në vitin 1944, falë kontributeve themelore të Uashingtonit, ekipi i Liç nisi eksperimentet brenda një kantieri ndërtimi ushtarak ultra sekret, Seal (Vula), që mendohej të zgjasnin për 1 vit. Duke u zhvilluar pranë gadishullit Uangaparaoa në veriun e largët të Zelandës së Re, projekti "Seal" thuhet se realizoi afro 4000 shpërthime në shkallë të vogël gjatë një periudhe 7-mujore. Objektivi: të kuptohej nëse ishte e mundur të nxitej krijimi i dallgëve të mëdha me anë të shpërthimit.

Nëse tezat e Liç do të rezultonin të sakta, Shtetet e Bashkuara mund ta kishin nënshtruar Japoninë përmes goditjes me cunami gjigantë të krijuara ndoshta nga bombat atomike të hedhura pranë brigjeve të saj. Sipas dokumenteve të projektit, të de-klasifikuara në vitin 1999, Liç kishte të drejtë: eksperimentet e tij kishin demonstruar mundësinë e shkaktimit të cunamit shkatërrues pas shpërthimit të të paktën 2 tonëve eksploziv 8 km larg nga bregu i synuar për të goditur.

Por ëndrra e bombës tektonike nuk u shua me projektin "Seal". Ajo u mor nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, e ndihmuar nga fillimi i Luftës së Ftohtë, dhe u shqyrtua më tej në kontekstin e projekteve të reja.

Ndërsa nuk dihet asgjë për kërkimet e kryera nga Shtetet e Bashkuara për çështjen e tërmetit artificial, cunamit dhe induksionit të shpërthimit, sepse ende sot janë sekrete, diçka ka dalë nga kërkimet sovjetike pas shembjes së Bashkimit Sovjetik.

Shkencëtarët ushtarakë të Bashkimit Sovjetik, përfshirë fizikanin e famshëm Andrej Sakharov, besonin vërtet në mundësinë e destabilizimit të pllakave tektonike të kores së Tokës përmes manipulimit të dhunshëm të elektromagnetizmit. Dhe duke ndjekur ëndrrën distopike të zgjimit të pllakës nën Parkun e Jelloustoun në SHBA, apo fundosjes së Kalifornisë duke ngacmuar çarjen tektonike San Andrea, ata investuan kohë dhe burime në tre projekte: Lavina, Merkuri dhe Vullkani.

Të cilësuara nga gjeofizika perëndimore si projekte me rezultate "pa shumë gjasë për sukses, por jo të pamundura", Lavina, Merkuri dhe Vullkani i angazhuan sovjetikët nga vitet 1970 deri në ditët e fundit të BRSS. Në fakt shpërthimi i fundit eksperimental brenda projektit Vullkani, u krye midis viteve 1991-1992.

## Përmbytja e madhe mbi Ho Shi Min

Të hulumtuara dhe të testuara në vende të largëta nga disa ushtri, por asnjëherë të prezantuara zyrtarisht nga askush, bombat tektonike kanë hyrë në imagjinatën kolektive falë teoricienëve të konspiracionit. Sa herë që ndodh një tërmet i fuqishëm apo cunami, konspiracistët pretendojnë se ngjarja tragjike mund të ketë qenë rezultat (i synuar apo dëm anësor) i një eksperimenti.

Kështu ndodhi në vitin 1998, në kohën e tërmetit të fortë që goditi Afganistanin, dhe që iu atribua testeve të kryera ose nga Pakistani ose nga India. Dhe po kështu supozohet se ndodhi sërish në vitin 2004, me cunamin e Oqeanit Indian në vitin 2010, kur lideri i atëhershëm i Venezuelës Hugo Çavez akuzoi publikisht Shtetet e Bashkuara se qëndronin pas tërmetit shkatërrues që goditi Haitin.

Ndërsa bombat tektonike vazhdojnë që të ndajnë gjeofizikantët, armët mjedisore të shkatërrimit, që kanë të bëjnë me ndryshimet e motit të shkaktuara nga njeriu, kanë qenë një realitet i dokumentuar, edhe pse pak i kuptuar, që nga fundi i viteve 1960. Gjatë viteve 1967-1972, në kuadër të operacionit Popeye, Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara mbollën re në rajonin e Indokinës me jodur argjendi dhe jodur plumbi me synimin për të zgjatur (dhe përkeqësuar) sezonin e shirave musonikë.

Lufta e parë e motit në histori ishte një sukses i papritur. Mbjellja e reve çoi në një përkeqësim të sezonit musonik, duke i zgjatur ato edhe me 30-45 ditë në krahasim me mesataren. Kjo solli përmbytje të pjesëve të tëra të zonave në xhungël dhe ngadalësimin e ndjeshëm të lëvizjeve të revolucionarëve vietnamezo-veriorë.

## E ardhmja e luftës është manipulimi i Tokës

E drejta ndërkombëtare është "kafazi" i fuqive të vogla dhe të mesme, dhe një shaka për fuqitë e mëdha. Kështu ka qenë gjithmonë. Për këtë arsye, pavarësisht ekzistencës së Konventës për ndalimin e përdorimit të teknikave të modifikimit të mjedisit për qëllime ushtarake apo për çdo qëllim tjetër armiqësor, e vitit 1978, protagonistët e arenës ndërkombëtare, të djeshme dhe të sotme, janë përpjekur dhe po përpiqen të zhvillojnë armët mjedisore të shkatërrimit në masë.

Nëse dje pionierët e armëve të tilla ishin Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara, përkatësisht në kërkim të bombave tektonike dhe të përfshira në një luftë meteorologjike, sot programet ushtarake kanë në fokus ndryshimin e klimës dhe prodhimin e dukurive katastrofike.

Në Rusi, një nëndetëse autonome e gjeneratës së re me energji bërthamore, Poseidon, është në një fazë të avancuar zhvillimi. Prodhuesit e saj e kanë reklamuar si të aftë për të gjeneruar dallgë me një ndikim shumë të madh. Nëse do të ketë sukses, ai do të jetë fryt i përpjekjeve të nisura me Lavina, Merkuri dhe Vullkani.

Në fillim të këtij viti, Koreja e Veriut testoi një dron nënujor, që sipas asaj që u raportua nga shtypi shtetëror "është i aftë të gjenerojë cunami radioaktivë". Kina, një vend ku programet e super-armëve mbahen shumë sekret, është periodikisht në qendër të teorive konspirative që e shohin atë të angazhuar në zhvillimin e armëve tektonike, të cilat më pas përdoren kundër Japonisë dhe Tajvanit.

Ndoshta armët tektonike mund të mos ekzistojnë ende, por ekuivalentët e tyre të motit kanë ekzistuar që nga vitet 1960. Me gjasë frika e nisjes së një lufte botërore do të jetë pengesa që do të bindë fuqitë e mëdha të mos i përdorin ato, duke krijuar një ekuilibër të ri. / "Il Giornale" – Bota.al




# Sport



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Kosova mëson rivalët për kualifikimet evropiane U17 dhe U19 për vajza



**Nion, 16 qershor** - Në selinë e UEFA-së në Nion të premten është bërë tërheqja e shortit për fazën e parë kualifikuese për Evropianin “Suedia 2024” për U17 dhe për Evropianin “Lituania 2024” për U19. Edhe këtë herë ekipet u ndanë sikurse në formatin e Ligës së Kombeve, në Ligën A dhe Ligën B. Kosova në të dyja grupmoshat është përfshirë në Ligën B, ku do të synojë të promovohet në Ligën A. Në shortin për U17, Kosova u përfshi në Grupin B1, ku bëjnë pjesë edhe Maqedonia e Veriut, Gjeorgjia dhe Armenia. FFK-ja do të jetë organizatore e miniturneut të këtij grupi, ndeshjet e të cilit do të zhvillohen më 3, 6 dhe 9 tetor. Kjo do të jetë hera e dytë që FFK-së i është besuar organizimi i një turneu të tillë nga UEFA. Ndërkaq, Kombëtarja U19 është përfshirë në Grupin B3 ku janë edhe Sllovenia, Azerbajxhani dhe Moldavia. Ndeshjet e këtij grupi do të zhvillohen në Slloveni, më 8, 11 e 14 nëntor.

# Kosova barazon me Rumaninë, ëndrra për kualifikim edhe me larg

“Dardanët” kanë barazuar në Prishtinë me Rumaninë dhe në këtë mënyrë janë edhe me larg ëndrrës për kualifikim në Evropian. Përzgjedhësi Alain Giresse ka thënë se fusha e rënduar pas reshjeve të shiut ndikoi në mos fitoren e Kosovës, derisa nuk heq dorë për kualifikim. “Përderisa na lejon matematika, ka gjithmonë një shans dhe ne nuk dorëzohemi”, ka thënë pas ndeshjes Giresse

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



**Prishtinë, 16 qershor** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka regjistruar barazimin e tretë radhazi në kualifikimet për Kampionatin Evropian “Euro 2024”, pasi luajti baras ndaj Rumanisë me rezultat 0-0. Në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri”, Kosova ishte dominuese ndaj Rumanisë, derisa arriti edhe të shënon gol, por pas rishikimit të VAR-it goli i Edon Zhegrovës nuk u pranua. “Dardanët” ishin dominues në pjesën e parë të ndeshjes, derisa i patën edhe tri raste të mira shënimi të cilat nuk arritën t’i konkretizon në gol, Muriqi, Cenia dhe Muslija. Edhe në pjesën e dytë, Kosova ishte skuadër më e mirë dhe dominimi ishte thuajse gjatë gjithë kohës. Vojvoda lëshoi një rast të mirë shënimi më pas edhe Zhegrova, derisa në minutën e 69-të, anësori i Lille, Edon Zhegrova realizoi për 1-0, por gjyqtari e anuloi pas rishikimit të VAR-it. Muriqi pati edhe një rast të mirë në fund të ndeshjes, por topi përfundoi mbi portën e mysafirëve dhe ndeshja përfundoi 0-0. Pas ndeshjes, trajneri i Kosovës, Alain Giresse ka thënë se gjendja e fushës ka ndikuar që “dardanët” nuk arritën të fitojnë ndeshjen. “Terreni dhe fati ndikuan. Në momentet e fundit mund të bënim më mirë. Por, terreni mbetet faktor kryesor në shkakun pse nuk gjetëm golin. Në fundin e lojës, Muriqi shpërdoroi rast të mirë. Përderisa na lejon matematika, ka gjithmonë një shans dhe ne nuk dorëzohemi”, ka thënë pas ndeshjes Giresse. Ky ishte barazimi i tretë i Kosovës në kualifikueset për “Euro 2024”, derisa të hënën përballet me Bjellorusinë në Budapest.

# Nora Gjakova, e argjendtë në Kazakistan

**Pejë, 16 qershor** - Xhudistja Nora Gjakova e ka fituar medaljen e argjendtë në Grand Slamin e Xhudos që po mbahet në Astana të Kazakistanit. Kampionia olimpike e Kosovës u ndal në finale nga francezja Sarah Leonie Cysique. Deri në finale Nora arriti duke shënuar katër fitore, njërën pa luftë, kategoria -57 kg. Gjakova fitoi edhe 700 pikë olimpike për “Paris 2024”. “Medalje e argjendtë për Norën në Ditën e Çlirimit të qytetit të saj të lindjes - Pejës! Nora Gjakova shënoi tri fitore për t’u ndeshur në finale me francezen Qysique e ku mirë e filloi luftën dhe u prit luftë e fortë, por një gabim i kushtoi, por kjo s’e humb shkëlqimin e medaljes së argjendtë të Norës dhe 700 pikë Olimpike! Mposhti me Ippon garueset nga Latvia, Polonia dhe në gjysmëfinale garuesen nga Holanda. Nora tashmë vulosi normën drejt Lojërave Olimpike dhe lufta është të mbetet në top 8 që të jetë ndër bartëset e grupeve”, ka shkruar Kuka në “Facebook”. Sot (e shtunë) garojnë Akil Gjakova (-73 kg), Laura Fazliu (-63 kg) dhe Loriana Kuka (-70 kg).




# Nuzës i besohet drejtësia në ndeshjen kualifikuese ‘Euro 2024’



Prishtinë, 16 qershor - Gjyqtari Genc Nuza ka marrë një superlajm nga UEFA, pasi ia ka besuar ndarjen e drejtësisë në kualifikimet për Kampionatin Evropian. Kjo është hera e parë që një gjyqtar i futbollit të Kosovës ndan drejtësinë në këtë nivel. Nuza do ta ndaj drejtësinë në sfidën Finlanda - San Marino, kurse do të ndihmohet nga Fatlum Berisha dhe Bujar Selimaj. “Kam kënaqësinë të ndaj me ju edhe një tjetër arritje si gjyqtar ndërkombëtar i futbollit. Kosova do të përfaqësohet edhe me gjyqtar në ndeshjet kualifikuese për ‘Euro 2024’. Jam shumë i lumtur për një tjetër sukses dhe se ky emërim për ndeshjen Finland - San Marino dëshmon edhe njëherë vlerësimin e punës sime profesionale nga ana UEFA-s. Krenar dhe i nderuar të jem gjithmonë gjyqtari i parë i Kosovës i cili bën debutime në kompeticione të rëndësishme ndërkombëtare ndër vite. Paraqitjet në stadiume siç është ‘Helsinki Olympic Stadium’ me shumë histori, dikur ishin ëndërr, tani janë realitet dhe se me punë do të synoj suksese edhe më të mëdha në të ardhmen. Së bashku me ekipin tim dhe kolegët nga Kroacia të cilët do të asistojnë nga sistemi VAR. Uroj të kemi fat dhe sukses!”, ka shkruar Nuza.

## Muja: Nuk refuzohet oferta e klubit më të madh në Kosovë



Prishtinë, 16 qershor - Ardian Muja është futbollisti më i ri i skuadrës së Prishtinës. Skuadra kryeqytetase e ka paraqitur futbollistin 25-vjeçar i cili në gjashtë edicionet e fundit ishte kapiten i Trepçës ’89. Muja ka nënshkruar për dy vjet me ekipin e Prishtinës, ndërsa në edicionin e fundit ka shënuar 6 gola dhe 2 asistime. “Nuk e pata të vështirë fare të pranoja ofertën ‘bardhekaltër’. Realisht Prishtina është klubi më i madh në Kosovë. Normalisht e ndiej veten të gatshëm të marr mbi supe skuadrën dhe të jap më të mirën edhe, pse jo, ta rikthejmë edhe titullin e kampionit në kryeqendër”, ka thënë Muja.

## Marku: Kam punuar shumë, këtë javë do të zyrtarizoj gjithçka

Tiranë, 19 qershor - Boksieri shqiptar Florian Marku ka bërë me dije në rrjetet sociale se këtë javë do ta zbulojë të ardhmen e tij. Ai do të zyrtarizojë si datën e rikthimit në ring ashtu dhe emrin e rivalit të tij. Marku, i pamposhtur në karrierën e tij, nuk duelon që prej gushtit të vitit të kaluar. "Falënderoj të gjithë nga zemra për përkrahjen. Nuk kam boksuar që nga muaji gusht, kur duelova në Shqipëri për shkak të një operacioni në dorë. Nuk jam mësuar të qëndroj kaq gjatë pushim dhe të mos jem aktiv, por jetës nuk i dihet kurrë", shprehet Marku. "Kam reflektuar shumë me gjithçka që ka ndodhur në jetën time, duke kaluar më shumë kohë me familjen. Kjo periudhë dhe fakti që jam bërë sërish baba ma ka shtuar më shumë vullnetin për të dominuar në divizionin e boksit ku unë ndeshem. Këtë javë do të zyrtarizoj gjithçka dhe mezi pres t'ju tregoj sa shumë kam punuar për të qenë në formën më të mirë", ka shtuar Marku.



# Rama premton stadium dhe pishinë olimpike në Prishtinë

Prishtinë, 19 qershor - Me aktivitete të ndryshme me nxënës nga shkollat e komunës së Prishtinës, të hënën është shënuar Dita Olimpike 2023, si ngjarje që përmbyll Javën Olimpike e cila u shënua me shumë aktivitete sportive në rreth 25 komuna në të gjithë Republikën e Kosovës.

Qëllimi i Javës Olimpike është që të rinjtë dhe nxënësit e shkollave fillore të merren me sport për një të ardhme të suksesshme në arenën ndërkombëtare.

Në hapjen e Ditës Olimpike, presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, i ftoi të gjithë fëmijët që të qëndrojnë sa më larg rrjeteve sociale dhe të merren me aktivitete sportive në mënyrë që një ditë të jenë të suksesshëm si Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Amir Rrahmani e kampion të tjerë.




Ndërkaq kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, u shpreh se Kosova po bëhet çdo ditë e më shumë krenare me përfaqësimin që sportistët po i a bëjnë nëpër botë me paraqitjet dhe sukseset e tyre duke fituar medalje të shumta. Ai tha se shumë shpejt në Bërnicë do të ndërtohet Qendra Olimpike, gjithashtu do të ndërtohet një stadium olimpik si dhe një pishinë olimpike. "Kemi shpalosur me krenari edhe konceptin tonë vizionar që tani po e quajmë Qendra Olimpike, një përpjekje madhështore kjo që po ndërtohet në Bërnicën e Poshtme. Edhe Prishtina po kthehet në kryeqendër sportive jo vetëm në Kosovë, po në të gjithë rajonin. Në këtë pjesë do të jenë stadiumi olimpik, arena multifunksionale, do të kemi edhe basenin olimpik, një numër të madh të sporteve olimpike, ku ju do t'i keni kushtet më të mira për t'i arritur majat më të larta botërore", ka theksuar Rama.

Gjatë Javës Olimpike u shënuan aktivitete të ndryshme në Prishtinë, Suharekë, Malishevë, Gjakovë, Rahovec, Drenas, Fushë-Kosovë dhe në Han të Elezit.

# Verstappeni: Shumicën e kohës garova me një zog që kishte ngecur në makinën time

Ottawa, 19 qershor - Piloti holandez Max Verstappen fitoi garën e Çmimit të Madh të Kanadasë në Formula 1, duke thelluar edhe më tej dallimin me rivalët. Dy herë kampioni i botës rrëfeu se gjatë gjithë garës ka garuar me frikë, pasi një zog kishte ngecur në makinën e tij. Në xhiron e 11-të ai i ka thënë skuadrës se goditi një zog, por nuk e uli ritmin, duke i dhënë Red Bullit fitoren numër 100 në historinë e Formulës 1. "Një zog ngeci në makinën time dhe garova me të në shumicën e garës", rrëfeu Verstappeni. "Ndihem keq për këtë që ndodhi, pasi pashë mekanikët që po përpiqeshin ta hiqnin pas garës dhe nuk dukej mirë".




Këtë gjë e konfirmoi edhe Christian Horner, shefi i Red Bull: "Zogu kishte ngecur në kanalin e frenave të makinës së Max Verstappenit. Përplasja me zogun dhe frika se mos kjo jepte pasoja te makina na bëri që të ishim në ankth. Ai kishte ngecur pas kanalit të frenimit të gomës së të djathtë përpara", ka shtuar ai. "Për fat, ai incident nuk ndikoi te makina e Maxit. Mund të them se gomat nuk shkuan në asnjë moment në temperaturën e duhur dhe kjo na penalizoi disi gjatë garës, pasi nuk ishim shumë të shpejtë. Kjo ndodhi për shkak të temperaturave të ulëta të ambientit dhe shiut që ra ditën e shtunë", ka deklaruar Horner.

## SHKURT

### Prapashtica: Dritës besimin do t'ia rikthej me punë

Sulmuesi Albin Prapashtica është një prej nënshkrimeve më të mëdha nga skuadra e Dritës në këtë afat kalimtar. Ish-sulmuesi i Prishtinës ka thënë se është shumë i lumtur që iu bashku njërit prej klubeve më të mëdha në vend. "Kënaqësi, privilegj e nder të jem pjesë e njërit prej klubeve më të mëdha në Kosovë. Mirënjohës për menaxhmentin e klubit që më kërkoi dhe më bindi për projektin serioz dhe afatgjatë. Do të punoj dhe kontribuoj shumë për klubin si shpërblim për besimin ndaj meje. Mezi pres të filloj këtë eksperiencë të re. Kam shumë për t'i dhënë klubit tim të ri, në veçanti 'Intelektualëve'", ka thënë Prapashtica.

### Asllani: S'ka asnjë shans të largohem nga Interi

Nga grumbullimi i kombëtares kuqezi, ku ndodhet prej gati 10 ditësh, mesfushori Kristjan Asllani ka folur për të ardhmen e tij. Edhe pse këtë sezon ai ka luajtur vetëm 859 minuta në total me fanellën e Interit, mesfushori kuqezi deklaron: "Nuk ka asnjë shans që unë të largohem nga Interi këtë verë". Asllani ka zbritur në fushë në 29 ndeshje, por shpesh si zëvendësues dhe ka luajtur për pak minuta. Megjithatë, mesfushori 21-vjeçar shqiptar nuk dorëzohet apo ankohet. "Nuk dëshiroj që të ik e të luaj diku tjetër në formë huazimi. Jam rritur shumë duke parë e mësuar nga Brozoviqi e Calhanoglu këtë sezon", ka deklaruar. "Shpresoj që t'i shfrytëzoj sa më mirë mundësitë që do të kem në sezonin e ardhshëm, por nuk do të marr në konsideratë asnjë ofertë për t'u larguar", u shpreh Asllani, që do ta nisë kështu sezonin e dytë me fanellën zikaltër, ku vjet nuk shënoi dot asnjë gol.

### Guardiola: Mbappe nuk vjen në City

Trajneri Pep Guardiola ka bërë me dije se ylli i Paris-Saint-Germain, Kylian Mbappe, nuk do t'i bashkohet Manchester Cityt. Mbappe së fundi bëri me dije se ka vendosur të mos qëndrojë në PSG përtej vitit 2024 dhe spekulimet mbi atë se cili do të jetë klubi i tij i ri janë të mëdha. Real Madridi përmendet si destinacioni më i mundshëm, por edhe Manchester Unitedi thuhet se është serioz në kërkim të shërbimeve të tij, ndërsa Manchester City është në këtë listë për shkak të fuqisë së madhe financiare të sheikëve arabë. "Ne nuk do të nënshkruajmë me Kylian Mbappen. Ai nuk do t'i bashkohet Cityt. Të gjithë ju e dini se ku dëshiron të shkojë ai", ka deklaruar Guardiola duke buzëqeshur.

### Kante, futbollist i ri i Al-Ittihadit

Mesfushori N'Golo Kante pas shtatë vjetësh ka vendosur të largohet nga Chelsea. Mesfushori francez karrierën do ta vazhdojë në Lindjen e Mesme, ku tanimë ka gjetur marrëveshjen me kampionin në fuqi Al-Ittihad. 32-vjeçari ka nënshkruar një kontratë katërvjeçare me klubin arab, ku do të ketë një pagë prej 25 milionë eurosh neto në sezon, derisa në këtë skuadër më herët u transferua edhe sulmuesi francez Karim Benzema. Kante, gjithashtu, do t'i ketë edhe të drejtat e imazhit si dhe marrëveshjet komerciale shtesë ku të ardhurat shkojnë tek ai.

## Trajneri i Spanjës: Kemi arritur diçka të jashtëzakonshme

Trajneri Luis De La Fuente pas 11 vjetësh pritje për të festuar një tjetër trofe evropian i dhuron Spanjës trofeun e Ligës së Kombeve në këtë edicion të tretë, duke pasur Portugalinë dhe Francën. Spanja e mposhti në finale Kroacinë pas ekzekutimit të penalltive. Luis De La Fuente, trajneri i Spanjës, nuk e fsheh gëzimin e tij për këtë sukses të rëndësishëm. "Nuk kam fjalë të përshkruaj këtë që ndiej për djemtë. Ata u treguan profesionistë të shkëlqyer. Kemi arritur diçka të jashtëzakonshme", ka thënë De La Fuente.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Personel i Sigurimit (2 pozita)
**Departamenti:** Administratë
**Divizioni:** Sigurim
**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit të Sigurimit
**Niveli i gradës:** 10

**Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësive:**

Detyrat e përgjithshme të Njësisë së Sigurimit Fizik të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) janë të përcaktuara përmes Politikës së Sigurisë Fizike të BQK-së. Bazuar në këtë politikë, personeli i sigurisë fizike do të kujdeset për sigurinë e BQK-së 24 orë në ditë, 7 ditë në javë gjatë tërë vitit.

BQK inkurajon të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për këto pozita pavarësisht gjinisë!

Më poshtë është bërë përmbledhja e përgjegjësive dhe detyrave të vendit të punës "Personel i Sigurisë Fizike":

- Të jetë vigjilent në mbrojtjen e pasurisë dhe personelit të BQK-s gjatë tërë kohës në detyrë;
- Të jetë i kujdesshëm dhe të ketë vetiniciativë në organizimin e pengimit të çfarëdo rreziku që mund t'i kanoset objektit dhe personelit të BQK-s;
- Të raportojë menjëherë për rastet të cilat paraqesin rrezik eventual ose tentimet e veprimeve të pa autorizuara të futjes në objekt etj. duke bashkëpunuar me Policinë e Kosovës;
- Të sigurojë që kushtet dhe rrethanat e sigurisë nuk rrezikojnë personelin e BQK-s, dhe duke respektuar rregullat intervenon në çdo situatë ku punëtori ose vizitori pëson ndonjë aksident, lëndim ose ndonjë humbje të gjësendeve të tyre;
- Të jetë në gjendje t'i kuptojë dhe t'i shfrytëzojë të gjitha pajisjet elektronike të sigurisë, si: sistemin e vëzhgimit me kamera, alarmet, etj. dhe të sigurojë të gjitha hapësirat brenda dhe jashtë objektit;
- Të sigurojë që evidencat për çfarëdo rasti apo incidenti të mbesin të paprekura deri të arrijnë autoritetet për hulumtimin e tyre;
- Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e pajisjeve elektronike të cilat shërbejnë për sigurinë – të raportojë menjëherë te udhëheqësi i DSF-së për çdo parregullsi të vërejtur;
- Ta kuptojë Politikën e Sigurisë Fizike të BQK-së, vendimet ekzekutive dhe urdhëresat administrative lidhur me sigurinë fizike, dhe t'iu përmbahet me përpikëri atyre;
- T'i përmbahet me përpikëri rregullores rreth punëve të përditshme të njësisë së sigurisë fizike;
- Të zbatojë të gjitha kërkesat lidhur me sigurinë të dhëna nga Udhëheqësi i Divizionit të Sigurimit, Drejtori i Administratës dhe Bordi Ekzekutiv i BQK-s.

**Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:**
- Diploma e Shkollës së Mesme;
- Tri (3) vite përvojë;
- Trajnime dhe certifikata në lëmin e sigurimit fizik apo mbrojtës së afërt të lëshuara nga institucionet kompetente të R. se Kosovës (të dëshirueshme):
- Njohuri për përdorimin e kompjuterit.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**
- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

**Procedura e aplikimit:**
- Afati i fundit për aplikim është: **04 korrik 2023**
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Pozicija:** Osoblje obezbeđenja (2 pozicija)
**Odeljenje:** Administracija
**Odsek:** Obezbeđenje
**Izveštava:** Rukovodilac odseka bezbednosti
**Nivo stepena:** 10

**Rezime dužnosti i odgovornosti:**

Opšti zadaci Jedinice za fizičku bezbednost Centralne banke Kosova (CBK) definisani su kroz Politiku fizičke bezbednosti CBK-a. Na osnovu ove politike, osoblje fizičkog obezbeđenja će se brinuti o bezbednosti CBK-a 24 sata dnevno, 7 dana u nedelji tokom cele godine.

CBK podstiče sve zainteresovane da se prijave za ove pozicije bez obzira na pol!

Ispod je sažetak odgovornosti i dužnosti radnog mesta „Osoblje za fizičko obezbeđenje":

- Da bude oprezan u zaštiti imovine i osoblja CBK-a tokom čitavog vremena na dužnosti;
- Da bude pažljiv i preuzme samo inicijativu u organizovanju sprečavanja svakog rizika koji može ugroziti objekat i osoblje CBK-a;
- Odmah da prijavi slučajeve koji predstavljaju potencijalnu opasnost ili pokušaje neovlašćenih radnji za ulazak u objekat i sl. u saradnji sa Kosovskom policijom;
- Da obezbedi da bezbednosni uslovi i okolnosti ne ugroze osoblje CBK-a, i poštujući pravila interveniše u svakoj situaciji u kojoj radnik ili posetilac pretrpi nesreću, povredu ili bilo kakav gubitak svojih stvari;
- Da bude u stanju da razume i koristi sve elektronske sigurnosne uređaje, kao što su: sistem za nadzor kamera, alarmi itd. i obezbediti sve prostore unutar i van objekta;
- Da osigura da dokazi za bilo koji slučaj ili incident ostanu netaknuti dok vlasti ne stignu na istragu;
- Da kontinuirano proverava rad elektronskih uređaja koji služe za bezbednost - odmah prijaviti načelniku DSB za uočene nepravilnosti;
- Da razume Politiku fizičke bezbednosti CBK-a, izvršne odluke i administrativne uredbe koje se odnose na fizičku bezbednost, i da ih se striktno pridržava;
- Striktno se pridržavati propisa koji se odnose na svakodnevni rad jedinice fizičkog obezbeđenja;
- Da sprovede sve zahteve koji se odnose na bezbednost date od strane Rukovodioca odseka bezbednosti, direktora administracije i izvršnog odbora CBK-a.

**Kualifikacije i zahtevana iskustva:**
- Diploma srednje škole;
- Tri (3) godine iskustva;
- Obuke i sertifikati u oblasti fizičke bezbednosti ili bliske zaštite izdati od nadležnih institucija Republike Kosovo (poželjno):
- Poznavanje upotrebe računara.

**Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:**
- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Popratno (motivaciono) pismo koje navodi vaše interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od strane nadležne institucije/organizacije;
- Izveštaj Trusta kojim se dokazuje vremenski period radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravištu na Kosovu.

**Postupak apliciranja:**
- Krajnji rok za apliciranje je **04 jul 2023**.
- Apliciranje se može vršiti on-line (https://hris.bqk-kos.org) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Nikakav drugi oblik apliciranja se neće uzeti u obzir.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- **Nekompletna dokumentacija se neće uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**

KMDK
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosovo Landfill Menagement Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

**KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH. A.**

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Neni 21 dhe neni 21.4, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, bazuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative pika 15.3 për Ndërmarrjet Publike.Bazuar në Vendimet Nr.10/2023 me numër të protokollit 01-33/11 dhe Nr.8/2023 me numër të protokollit 01-33/9 të dt.16.06.2023 të Bordit të përkohshëm i Drejtorëve të KMDK-së, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Republikën e Kosovës shpall këtë:

**KONKURS PUBLIK**
**(PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS)**

**Titulli: Kryeshef Ekzekutiv në KMDK SH.A**

**Numri i Referencës: ZP/KJ-10-2023.**
**I raporton: Bordi i Drejtorëve**
**Niveli i pagës: Niveli I.**
**Orët e Punës: 40 orë në javë.**
**Mandati: 3 vite**
**Vendi i punës: Prishtinë.**

***Detyrat dhe përgjegjësitë:***

**Përshkrimi gjeneral;**

1.) KE është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të kompanisë, KE është përgjegjës për suksesin e përgjithshëm dhe përfundimtar për të gjitha veprimet e ndërmarra, për dhënien e drejtimit (lidershipit) dhe për sigurimin e udhëzimeve për të gjitha çështjet e rëndësishme, po ashtu është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet dhe shërbimet e KMDK-së janë ngritur në nivelin më të lartë të përformancës së mundshme.
2.) KE për punën e tij i përgjigjet Bordit të Ndërmarrjes në përputhje me LNP dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

**Kompetencat;**
-Udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e zhvillimeve të përditshme të kompanisë.
-Përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha nivelet, strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset e subjektit të sektorit publik, në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar dhe transparencës, dhe i raporton udhëheqësit të sektorit publik, ose organit raportues përkatës sipas legjislacionit në fuqi.
-Për zbatimin e përgjegjësisë së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Kryeshefi Ekzekutiv:
- Siguron që vendimet dhe masat tjera të subjektit të sektorit publik të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive;
- Identifikon fushat me rrezik për realizimin e objektivave të subjektit publik dhe ndërmerr veprime për minimizimin e rreziqeve;
- I propozon udhëheqësit të subjektit miratimin e akteve të brendshme administrative;
- Monitoron sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të subjektit publik; dhe
- Ndërmerr veprime për përmirësimin e sistemeve në pajtim me rekomandimet e auditimit të brendshëm, auditimit të jashtëm dhe me analizat tjera.

-Përparimin e përgjithshëm të udhëheqjes së besuar, përfshirë edhe menaxhimin e buxhetit që i është vënë në dispozicion.
-Kontrollin e buxhetit, afatet kohore, kualitetin e planifikimeve, kualitetin e burimeve (resurseve) brenda kompanisë.
-Sigurimin që Kompania përgjatë gjithë kohës është në përmbushje të kërkesave dhe objektivave nga PB si dhe duke iu përmbajtur afateve te miratuara kohore.
-Mirëmbajtjen e përgjithshme të përgjegjësisë për të gjitha sektorët.
-Nënshkruan kontratat e të të punësuarve të kompanisë në konsultim me udhëheqësit e departamenteve dhe sektorëve.
-Miratimin e ndryshimeve në përshtatje të afateve kohore të resurseve dhe buxhetit, me përjashtim të atyre që miratohen në Bord.
-Detyrat të tjera të përcaktuara me Kodin e Etikës dhe Qeverisjës Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe Statutit të Kompanisë.

**Kualifikimet dhe përvoja e punës;**
-Diplomë Universitare, (minimum 4 vite pas shkollës së mesme) në fushat të ndërlidhura me aktivitetet në të cilat vepron Kompania;
-Së paku 5 vite përvojë pune në fushat relevante – së paku 3 vite duhet të jenë në nivel të lartë menaxherial;

**Aftësitë kryesore;**
-Shkathtësi të dëshmuara njerëzore dhe të menaxhmentit në një kompani ose organizatë të ngjashme;
-Njohuria praktike mbi sektorin e menaxhimin të mbeturinave do të ishte përparësi;
-Shkathtësi të mira kompjuterike;
-Të flas rrjedhshëm gjuhën shqipe ose serbe;
-Njohja e mirë e gjuhës angleze është e preferueshme.

***Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara e punës:***
Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas Ligjit për ndërmarrjet Publike nenit 17.1, (ii) plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pika d, f, j, k, l dhe (iii) kanë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë, me kusht që (i) Kryeshefi Ekzekutiv të posedojë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale.

***Procedura e konkurrimit***

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrën e KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: https://kmdk-ks.org/. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrat e KMDK SH.A në adresën: Rruga "Bekim Fehmiu" Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës "Shtjefën Gjeçovi"), "Lakërishtë". Tel: 038/ 600 – 552.

***Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:***

- Aplikacioni,
- CV e detajuar ( formati Europass),
- Kopja e letërnjoftimit ose Pasaportës me afat,
- Letër e Motivimit,
- Kopje e Diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për Diplomat e marra jashtë vendit;
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga Institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, qe e përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qene te detyruar të paguajnë në këtë Institucion);
- Deklarata nën Betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 te Ligjit të NP-së e cila mund te shkarkohet ueb faqja e Kompanisë;
- Çertifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);

***Shënim:*** *Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.*

Afati për aplikim është tridhjetë (30) ditë kalendarike nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së vendoset https://kmdk-ks.org/?page=1,7 qe e pranon dokumentacionin, duke filluar nga data: 19.06.2023 deri me datën 18.07.2023 ora 08:00-16:00h.

***Vërejtje:***

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.Dokumentacionet të dorëzohen me zarf të mbyllur.

**Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyrën e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A**

Email: info@kmdk-ks.org

Tel: 038/ 600 552.

------------------------------------------------------------------------------------------------------

**Titulli: Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit – *ZKFTH***

**Numri i Referencës: ZP/KJ-11-2023.**
**I raporton: Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv**
**Niveli i pagës: Niveli II.**
**Orët e Punës: 40 orë në javë.**
**Mandati: 3 vite**
**Vendi i punës: Prishtinë.**

***Detyrat dhe përgjegjësitë:***

